



Këshilla për një

marrëveshje lidhur me përdorimin e mediave

- Marrëveshjen përpilojeni bashkë me fëmijët tuaj.
- Përdorimi i mediave përfshin televizionin, videot, kompjuterin dhe internetin.
- Mos e përcaktoni vetëm sa kohë mund të përdoren mediat, por edhe kohën kur mund të përdoren ato.
- Është më praktike të caktohet orari javor për përdorimin e mediave, sesa orari ditor.
- Përcaktojeni nëse dhe në çfarë mase do të llogaritet përdorimi i mediave të reja gjatë orarit javor të përdorimit të tyre në raport me detyrat e shtëpisë.
- Përcaktojeni se cilat oferta (chat, rrjetet sociale dhe lojërat kompjuterike) lejohet të përdoren.
- Vendosni rregullat e sjelljes për chat, për rrjetet sociale dhe për lojërat kompjuterike. Këto duhet të vlejné parimisht edhe jashtë shtëpisë.
- Përcaktojeni që kufijtë e moshës për filmat, programet televizive dhe lojërat kompjuterike duhet të respektohen në mënyrë strikte.
- Caktoni bashkërisht rregullat për mënyrën e trajtimit të përmbajtjeve të papërshtatshme. Shpjegojuani fëmijëve tuaj që mediat e reja nuk paraqesin vakum ligjor dhe se posedimi i pornografisë hardcore apo materialeve me përmbajtje dhune kundër njerëzve dhe kafshëve është e dënueshme me ligj. Por jepuni fëmijëve tuaj edhe besimin që gjithmonë jeni në dispozicionin e tyre për të biseduar me ju.
- Vendosni bashkë me fëmijën tuaj si duhet të bëhet kontrollimi i zbatueshmërisë së rregullave në fjalë.
- Insistoni që rregullat të zbatohen.
- Përcaktoni pasojat në rast të mosrespektimit të rregullave.
- Vendosni rregulla edhe për vetveten. Veç tjerash, fëmijët nuk duhet të "spiunohen".
- Mos i shfrytëzoni mediat e reja as si mjet dënimi as si mjet shpërblimi.
- Koordinojeni marrëveshjen tuaj me rregullat për përdorimin e mediave të reja në shkollën e fëmijëve tuaj.
- Përshtateni marrëveshjen kohë pas kohe. Fëmijët zhvillohen dhe mund të marrin më shumë përgjegjësi me kalimin e kohës.

.....
Për informata të mëtejshme mbi edukimin mediatik, kompetencën mediatike, për rrjetet sociale, lojërat kompjuterike apo edhe për aspektet ligjore të përdorimit të mediave vizitoni faqen www.elternet.ch (në gjermanisht).

